



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Data ____ / ____ / 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje kontenier”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi PCV 44613600-6 “Kontenierë me rrota”

Kodi PCV 44613800-8 kontenierë për mbeturina

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fond limit : 2 910 160 *(dy milion e nëntëqind e dhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë)* lekë pa tvsh, të vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Kuçovë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.1 Ofertuesi duhet të paraqesi Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 15% të vlerës së fondit limit.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes (të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 15 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar dhe konkretisht gjërmës a) të pikës 4 të nenit 55 të VKM së sipërcituar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë në emër të vet për objektin e prokurimit, që vërteton cilësinë e menaxhimit të cilësisë, ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vetë natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që ofertuesit duhet të jenë të certifikuar për cilësinë si dhe të kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë.

Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe certifikata ekuivalente të ISO 9001:2015, e cila i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me sukses dhe në kohë dhe ku kontenierët të jenë standartit të cilësisë ISO 9001:2015.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për mallrat objekt prokurimi, shoqëruar me një perkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si : telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktore në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributor, operatori ekonomik duhet ta vërtetojë duke paraqitur akt marrëveshje/autorizim/kontrate lidhur mes kompanisë prodhuese dhe distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të V.K.M Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Autorizimi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofruesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësor të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtëpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmerinë e OE ofrues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben AK për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës duke garantuar këtë të fundit për lëvrimin e mallrave objekt prokurimi me sukses dhe brenda afatit të përcaktuar në DST.

2.2.4 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie në të cilën të jenë të përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike do të fillojë nga data e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi dhe do të jetë 1 (një) vit.

2.2.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cileë të deklarojë se merr përsipër transportin e konteniereve pranë autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen tek autoriteti kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standarteve të kërkuara.

- Çertifikatat ISO e kërkuar sipas DST.

Argumentim

Referuar karakteristikave që kanë certifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, lidhur me standartet, si dhe mënyrës më anë të së cilës subjektet certifikohen nga trupat e akredituara të certifikimit, njësia e prokurimit gjykon se certifikimet sipas standarteve ISO 9001:2015 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë); e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent, janë certifikime ekskluzive, tërësisht individuale dhe që lidhen ngushtë vetëm me plotësimin e standarteve mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë, sistemin e menaxhimit të mjedisit dhe sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, të subjektit i cili certifikohet, pasi i është nënshtruar auditimeve përkatëse nga trupat certifikuese. Pra, përse kohë certifikimet mbi standartet e mësipërme, janë tërësisht personale të subjekteve, AK vlerëson se, certifikimi lidhur me plotësimin e standarteve nga një subjekt nuk mund të garantojë se subjektet e tjera që mbështetet i plotësojnë këto standarte, pavarësisht tipologjisë të objektit të veprimtarisë së subjektit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të veprohet konform parashikimeve të LPP.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet janë si më poshtë :

1. Materiali: Çelik i galvanizuar .Cilësia e kontenierëve metalikë të xinguar 1100 litrash të jetë e tillë që të lejojë jetëgjatësi nën një përdorim intensiv dhe ti bëjë ballë kushteve klimaterike, kimikateve, goditjeve, gërryerjes dhe zjarrit.
2. Kontenierët të jenë lehtësisht të riparueshëm dhe të mund të saldohen (trupi i tyre dhe rrotat) .
3. Kontenierët të jenë të rinj, të papërdorur, të prodhuar sipas normave të komunitetit europian, në përputhje me standartet europiane EN-840 ose ekuivalent, dhe me certifikatë cilësie ISO 9001:2015 ose ekuivalent.
4. Kapaciteti mbajtës i tyre të jetë 1100 L.
5. Fuqia mbajtëse e peshave të koshave të jetë jo më e vogël se 700 kg.
6. Peshë e kontenierit bosh të jetë jo më e vogël se 100 kg .
7. Përmasat e kontenierit : Lartësia: (max)- 1400 mm; Gjerësia: (max) - 1100 mm; •Gjatësia: (max) - 1370 mm.
8. Kontenierët të jenë të kompletuar me rrota, frenin e këmbës dhe dorezat e tërheqjes etj.
9. Procesi i montimit të kontenierit të realizohet nëpërmjet saldimit me tel në mënyrë të vazhdueshme

10. Fundi i kontenierit (vaska) është pak i harkuar, pa damarë , pa tehe të mprehta, me system kullimi për derdhjen e lëngjeve i përshtatur për të parandaluar depozitimin mbetjeve apo gajtë larjes së kontenierit duke garantuar higjenë maksimale.
11. Kontenieri të mos ketë skaje të mprehta në mënyrë që askush të mos dëmtohet
12. Trupi i kontenierit (vaska) dhe të gjithë aksesorët të jenë celik i zinkuar kundër korozionit dhe më sipërfaqe të lëmuar.
13. Kontenierët të jenë me me lllamarinë me trashësi 1.5 – mm dhe 100 % të zinkuar (llamarinë që mbulohet me një shtresë zinku)
14. Konstruksioni i kontenierit është i përforcuar me brinjë rigjide për të rritur shtangësinë që të mos deformohet nga ngarkesa
15. Kontenierët do të kenë shenja dalluese fosforeshente, gdhenje ose stampime në përputhje me kërkesat e blerësit .
16. Kontenierët të jenë me 4 rrota, për manovrim të lehtë nga punëtorët edhe aks për mjetin teknologjik
17. Rrotat e kontenierëve të jenë me diametër 200 * 50 mm, të realizuara me celik të galvanizuar në qendër dhe unazë me goma mishi, shumë rezistente në pjesën e kontaktit me tokën
18. Të 4 rrotat e kontenierëve të kenë lëvizshmëri 360 gradë, me mekanizëm frenimi të dy rrotave para, Aksi i tyre të jetë me kuzhineta.
19. Kontenieri të ketë ekstra përforcim të bazës së rrotës
20. Sistemi ngritës është Model standart, në përputhje me standartet europiane EN-840 I ose ekuivalent përshtatshëm për tu ngarkuar nga cdo lloj makine teknologjike .
21. Kontenieri të jetë i paisur me forma për tu kapur nga tipe të ndryshme makinash

Këto specifikime teknike janë të nevojshme për të garantuar që kontenierët të jenë cilësorë, të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për përdorim afatgjatë në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane. Përdorimi i çelikut të galvanizuar dhe standardeve europiane siguron rezistencë ndaj korrozionit, kushteve atmosferike, goditjeve dhe konsumimit nga përdorimi intensiv i përditshëm.

Kërkesat për trashësinë e lllamarinës, peshën minimale dhe konstruksionin e përforcuar janë të domosdoshme për të shmangur deformimet dhe dëmtimet gjatë transportit, ngritjes mekanike dhe ngarkesave të rënda. Po ashtu, sistemi i saldimit të vazhdueshëm dhe mundësia për riparim rrisin jetëgjatësinë dhe ulin kostot e mirëmbajtjes.

Pajisja me rrota rezistente, mekanizëm frenimi dhe sistem ngritës sipas standardit EN 840 ose ekuivalent garanton siguri dhe kompatibilitet me mjetet teknologjike ekzistuese të pastrimit. Ndërkohë, sistemi i kullimit, mungesa e skajeve të mprehta dhe sipërfaqet e lëmuara sigurojnë higjenë, lehtësi në pastrim dhe mbrojtje për punonjësit dhe qytetarët.

Certifikimet ISO dhe përputhshmëria me standardet europiane janë të nevojshme për të garantuar cilësinë e prodhimit, sigurinë në punë dhe respektimin e kërkesave mjedisore, duke siguruar që produkti i furnizuar të jetë i standardizuar dhe me cilësi të lartë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se hartimi i specifikimeve teknike është kryer në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Mosplotësimi i specifikimeve teknike si më sipër cituar nga ana e operatorëve ekonomik ofertues, do të çojë në skualifikimin e operatorit ekonomik.

NJËSIA E PROKURIMIT